



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2024

A M E N D A M E N T

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR
DHËNIE AMNISTIE”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, propozoj amendamentet me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1

Kudo në projektligj data “31.01.2024” zëvendësohet me datën “31.03.2024”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen si vijon:

“1.1 Përfshihen nga vuajtja e dënimit, pavarësisht masës së dënimit, personat e dënuar për veprat penale të kryera gjatë grumbullimeve dhe manifestimeve të zhvilluara deri në datën 31.03.2024, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, të parashikuara në nenin 150, në paragrafin e parë të nenit 151, në paragrafin e parë të nenit 235, në paragrafin e parë të nenit 236, në paragrafin e parë të nenit 237, në paragrafin e parë të nenit 282, në nenin 293, dhe nenin 325 të Kodit Penal.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 1, të këtij neni, nuk përfshihen nga vuajtja e dënimit:

- a) personat e dënuar, akuzat penale ndaj të cilëve janë gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të shkronjave “b”, “c” dhe “c” nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.
- b) personat, të cilët i janë shmangur drejtësisë, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 5, bëhet shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, togfjalëshi “*1 vit e gysmë*” zëvendësohet me togfjalëshin “*dy vite*”.
2. Në pikën 1, shkronja “b”, togfjalëshi “*1 vit*” zëvendësohet me togfjalëshin “*1 vit e gjysmë*”.
3. Shkronja “c”, e pikës 2, ndryshohet si më poshtë:
“c. personat e dënuar, akuzat penale ndaj të cilëve janë gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të shkronjave “b”, “c” dhe “ç” nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.”.

Neni 4

Në nenin 6, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtjen si vijon:

“1/1. Përrjashtohen nga ndjekja penale të gjitha çështjet penale në hetim, çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në organet përkatëse, për veprat penale të kryera gjatë grumbullimeve dhe manifestimeve të zhvilluara deri në datën 31.03.2024, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, të parashikuara nga nenet 150, paragrafi i parë i nenit 151, paragrafi i parë i nenit 235, paragrafi i parë i nenit 236, paragrafi i parë i nenit 237, paragrafi i parë i nenit 282, nenit 293 dhe nenit 325 të Kodit Penal.”.
2. Pika 3 bëhet:
“3. Nuk përfitojnë nga pika 1 e këtij neni subjektet që kanë detyrimin për të deklaruar sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe subjektet e posaçme, akuzat penale ndaj të cilëve gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

sipas përcaktimeve të shkronjave “b”, “c” dhe “ç” nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.”

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
KRYETARI**

Gazment BARDHI